

VENDIM
Nr. 593, datë 1.7.2015

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NDËRMJET PROGRAMEVE TË MIRATUARA NË
BUXHETIN E VITIT 2015, PËR MINISTRINË E KULTURËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 160, datë 27.4.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve të miratuara në buxhetin e vitit 2015, për Ministrinë e Kulturës, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor (08230) “Arti dhe kultura”, në llogarinë “Investime”, (231) të zbritet fondi prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh.

b) Në programin buxhetor (01110), “Planifikim, menaxhim, administrim”, në llogarinë “Investime”, (231) të zbritet fondi prej 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekësh.

c) Në programin buxhetor (08220), “Trashëgimi kulturore dhe muzetë”, të shtohet, në zërin “Investime”, fondi prej 8 500 000 (tetë milionë e pesëqind mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve për shpronësimin, për interes publik, të pasurisë, pronë private, që preket nga zbatimi i projektit “Rehabilitimi i Amfiteatrit të Durrësit”.

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama